


## HEQJA E NJË PJESE TË QAFËS SË MITRËS ME NJË UNAZË ELEKTRO-KIRURGJIKALE (LLETZ)

### Të nderuar!

Trajtimi që ju propozojmë kërkon miratimin tuaj. Përpara se të merrni një vendim, dëshirojmë t'ju njohim me këtë shpjegim me shkrim dhe bisedë me mjekun për metodën, kuptimin, pasojat e mundshme negative dhe rreziqet e operacionit të propozuar.

### PËRSHKRIMI I SËMUNDJES DHE NDËRHYRJES

Për shkak të ndryshimeve patologjike të vërejtura në pap test ose ndryshimeve parakanceroze në qafën e mitrës të konfirmuara nga ekzaminimi histologjik, është e nevojshme të pritët një pjesë e indit të qafës së mitrës në mënyrë që të hiqen plotësisht qelizat e ndryshuara.



Operacioni mund të kryhet nën anestezi të përgjithshme ose lokale dhe zakonisht zgjat 15 minuta. Gjatë procedurës, kirurgu përdor një unazë elektro-kirurgjikale për të prerë pjesën e qafës së mitrës aty ku qelizat e ndryshuara mund të shihen me anë të një lënde kontrasti të veçantë. Madhësia e unazës varet nga shtrirja e ndryshimit. Indi i hequr dërgohet për ekzaminim histo-patologjik (një patolog ekzaminon qelizat në mikroskop). Së fundi, hemorragjia duhet të ndalet në zonën e indit të hequr - kirurgu kauterizon zonën e hemorragjisë me një instrument elektrik. Rrjedhja e gjakut mund të ndodhë disa ditë pas procedurës. Për shkak të natyrës së procedurës, ekziston mundësia ***që skajet e indit të mos priten në***

***një formë të shëndetshme***, kështu që ndonjëherë duhet të përsëritet - reLLETZ.

### KOMPLIKACIONET (ngjarje të padëshiruara, të paplanifikuara gjatë dhe pas operacionit):

Komplikacionet me operacionin LLETZ janë të rralla, por nëse ndodhin, janë kryesisht ***inflamacioni, hemorragjia dhe dëmtimi i organeve të afërta***.

**Inflamacioni** - është rezultat i hyrjes së baktereve në plagën kirurgjikale gjatë ose pas operacionit. Plaga bëhet e kuqe, dhimbja shtohet, mund të shfaqet një temperaturë e ngritur dhe një rrjedhje purulente dhe me erë të keqe. Kërkohej trajtim me antibiotikë.

**Hemorragjia** - si rregull, zgjat deri në 7 ditë dhe nuk duhet të jetë më e rëndë se periodat mujore. Mund të ndalet duke e kauterizuar sërish zonën e hemorragjisë me një instrument elektrik ose duke vendosur një qepje në enën që rrjedh gjak, ose duke vendosur një tampon (shirit në vaginë).

Ndodh jashtëzakonisht rrallë që të ***dëmtohen organet e afërta***. Në varësi të natyrës së dëmtimit, është e nevojshme një ndërhyrje kirurgjikale shtesë; edhe hapja e zgavrës së barkut dhe kujdesi jo i duhur mund të përbëjnë komplikacion.

Komplikacionet gjatë operacioneve trajtohen në mënyrë efektive dhe kryesisht nuk lënë pasojë, por zakonisht shërimi është më i gjatë dhe kërkon barna dhe ndërhyrje shtesë. Nëse vëreni shenjat e listuara të komplikacioneve të mundshme, kërkoni ndihmë nga gjinekologu i zgjedhur ose nga Reparti i Obstetri-Gjinekologjisë në numrin e telefonit +386 3 423 33 42 ose +386 3 423 33 45.

Reparti i Obstetri-Gjinekologjisë

Kodi i katalogut: GPGO-01

Dhjetor 2017, versioni 1